



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNES-MALISHEVE
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVA-SKUPSTINA OPSTINE MALISHEVO



PRANUAR ME:

ACCEPTED ON:

PRIMIJENO:

NUMERI:

11/12/2024.

02/448.



REPUBLIKA E KOSOVËS KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi Komunal Malishevë

PROCESVERBAL

i mbledhjes së-VI- (gjashtë) të rregullt të Kuvendit Komunal të Malishevës

RENDI DITËS

1. Shqyrtimi dhe miratimi kërkesës nr.01/161 datë:28.03.2024
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/204 datë:17.05.2024
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/358 datë:20.08.2024
4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/353 datë:09.08.2024
5. Shqyrtimi dhe miratim i kërkesës nr.08/363 datë: 22.08.2024

Mbledhja u mbajt me datë: 03.09.2024 dhe filloi në ora:10:20. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 20 asamblistë, Drejtori për Buxhet dhe Financa Blerim Thaçi, përfaqësuesi nga OSBE-së Sead Raba dhe zyra për informim. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Malishevës z. Argjend Thaçi.

Argjend Thaçi: Përshëndetje për të gjithë!

Mirë se keni ardhur në mbledhjen e gjashtë të rregullt të Kuvendit të Malishevës. Prezent jemi 20 anëtarë, kemi kuorum dhe mund të vazhdojmë më punimet e mbledhjes. A e dëshironi fjalën jashtë rendit të ditës?

Urdhëro, Amrush!

Amrush Helshani (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Jemi në fillim të vitit të ri shkollorë 2024/2025, e shfrytëzoj rastin që të uroj që të gjithë nxënësit dhe mësime të reja për fillimin e vitit të ri shkollorë, duke ju dëshiruar shëndet dhe arritje të suksesshme për secilin nxënë dhe secilën shkollë. Kësaj i bashkangjes dhe shqetësimet e shumta të prindërve mbi subvencionimin e librave në shkollë. Mendoj që kjo është një mos organizim i mirë i Ministrisë së Arsimit, me të cilin po humbin fëmijët me mungesë të librave, dhe prindërit po obligohen që të humbin dhe punën për ti siguruar këto libra. Në librarit tona ka mungesë të librave dhe sidomos niveli klasa 6

deri në klasën e 9. Shkollat dhe nxënësit duhet të furnizohen me libra dhe jo të krijohen tollovi dhe ngarkesë në vend që të fillojë ky vit pa këto probleme.

Vera kishte dhe telashe të tjera që dua të veçoj reduktimet e energjisë elektrike. Drejtori, nuk qenka prezent sepse e kisha edhe një pyetje për të.

Sa i përket zjarreve dua ti ftoj organet kompetente që të shqiptojnë dënime për shkaktarët e atyre zjarreve.

Kryesusi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Arlind!

Arlind Morina (anëtar nga LDK): Uroj të gjithë nxënësve të komunës së Malishevës fillim e vitit të ri shkollorë!

Kryesus, unë kam një kërkesë për ty dhe gjithë anëtarët e kuvendit. Është viti i tretë i mandatit tonë dhe disa komisione që janë zotuar nga ekzekutivi, ende nuk kanë filluar që të ju ekzekutohen pagesat për asnjë komision, përveç dy komisioneve obligative. Kolegët e mi në mbledhjen e kaluar janë zotuar që nëse nuk ekzekutohen pagesat për komisione ne nuk do të mbajmë mbledhje. Unë kërkoj një pauzë 5 minuta me shefat e grupeve dhe kërkoj që kjo seancë të shtyhet në shenjë revolte për mos pagesën e anëtarëve të komisioneve.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj (anëtar nga PDK): Pyetja e parë është për objektin e Benafit, qfarë statusi ka për momentin dhe në cilat faza është ai. A është në fazën e gjykatës apo si është gjendja e tij është mirë që të na jepet një informacion.

Te Drejtoria për Kadastër ka disa ditë dhe muaj që kopjet e planeve të parcelave nuk është duke i lëshuar kjo drejtori dhe qytetarët janë duke pasur telashe tek noteri sepse pa kopje të planit nuk mund të vazhdojë as kontrata tek noteri. A kemi probleme me paisjet përcjellëse për drejtorinë e kadastrit apo ku është problemi?

Sa i përket energjisë elektrike, për ne ka qenë shqetësuese së pari si qytetarë dhe në të njetën kohë dhe për bizneset të cilët 12 orë janë pa energji elektrike dhe secila nga këto e ka një kosto që është duke e shpenzuar në derivate për shkak të punëve të cilat i kanë në bizneset e tyre, më shqetësuese është për fabrikat të cilat janë duke punuar me gjenerator. Drejtor, unë mendoj që kryetari i komunës ka fuqi ekzekutive në këtë drejtim. Mirë është që takoheni dhe të merrni një vendim rreth kësaj qështje.

Qështja tjetër që dua ta ngris është tek investimet kapitale, drejtori është dashur të ishte këtu që të ballafaqohet me faktet dhe argumentet dhe faktet që ne kemi ke i dhënë sot këtu. Në investimet kapitale tash që janë duke u zhvilluar rrugët në fshatra, ka rrugë në fshatra të cilat nuk janë në projekt buxhet dhe asfaltohen, ka rrugë që është shtruar në pronë private, ka rrugë që është devijuar brenda fshatit, ka rrugë në projekt buxhet të cilat janë të asfaltuar gati qe 10 vite, ka rrugë që është e asfaltuar me participim. Kjo nuk do koment dhe nuk e di si po ja lejoni vetit në këtë form të punoni dhe të shkoni tutje. Nuk është e lehtë ti dërgosh atje investimet pa asnjë bazë

ligjore. Vendimet e kuvendit janë vendime të cilat je i obliguar ti zbatosh.

Qështja tjetër që e kam ngritur gjithmonë është e-kioskat, të cila çdo vit kanë qenë të planifikuara për vendosjen në Kijevë dhe në Malishevë dhe asnjëherë nuk është duke ndodhur vendosja e tyre. Ka qenë shumë e nevojshme që në këtë sezon me e pasur një e-kiosk në Malishevë ose në Kijevë, që qytetarët në mënyrë digjitale ti nxjerrin dokumentet e tyre.

Te dëgjimet publike, pse KPF -ja dhe Drejtori për buxhet nuk janë bashkë në ato dëgjime. Qfarë organi jeni ju, mos shkoni në KPF, dhe kërkesat le ti sjellin drejt në kuvend. KPF-ja është organ filtrues i kuvendit dhe KPF-ja së bashku me drejtorin duhet të dalë me i marrë kërkesat.

Sa i përket mbeturinave, këtë qështje e kam ngritur në çdo mbledhje, rruga që lidh Senikun me Banjën është në gjendje të tmerrshme, dhe sigurisht që ndezja e zjarreve ndodh dhe për këtë arsye, sepse ka pasur zjarr aty dhe komplet pronat e Senikut janë djegur. Ato mbeturina duhet të pastrohen, ka një kompani që është aktive, ka një kontratë që duhet ti pastrojë ato.

Te uji i pijes kemi pasur telashe dhe është mirë që ti jepni një drejtim kësaj. E keni dhënë arsyen që qeveria nuk ju ka mbështetë në projekt, mirëpo është mirë të futën disa projekte të cilat ju mendojnë që i keni dhe është dashur që të filloni. Unë mendojë që uji dhe kanalizimi është prioritet për ju dhe për ne.

Te zjarrëfiksat- kanë qenë me një pomp të ujit të cilët ju ka dalur në ndihmë 42 fshatrave. Nuk mundesh me një pomp të ujit të kryhen 42 fshatra. E vetmja zgjidhje është që ju si qeverisje ti krijoni disa grupe njerëzish që të jenë aktiv në kohë zjarri.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Para vazhdimit të diskutimit kërkoj nga grupet parlamentare përgjigje në lidhje me kërkesën e Arlindit. Urdhëro, Halil!

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Ne mundemi të dalim si grupe që të diskutojmë mirëpo konsideroj që vetëm që i bëjmë dhe një telashe vetit që të vimë pas 3-4 ditëve.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Shkojmë 5 minuta në një konsultim me shefat e grupeve.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Nga diskutimi me shefa të grupeve parlamentare erdhëm në një përfundim që të kërkojmë përgjigje përfundimtare nga Drejtori për Buxhet dhe Financa rreth pagesave të komisioneve dhe komiteteve jo obligative të cilat i ka formuar kuvendi komunal i Malishevës. Kryetari dhe drejtori është zotuar që do të kryhen këto pagesave, një gjë e tillë nuk ka ndodhur dhe kërkojmë dhe njëherë se qka ka ndodhë dhe si do të shkohet më tutje me pagesat e këtyre komisioneve. Urdhëro, drejtor!

Blerim Thaçi Drejtor për Buxhet dhe Financa: Në KPF-ë kam kërkuar dhe nga kryesuesi dhe nga përfaqësuesit e subjekteve politike që të bëhen tre ose pesë anëtarë që të shkojmë bashkë në Ministri të Financave dhe le të na tregojnë formën e realizimit të obligimeve që ka krijuar kuvendi dhe drejtpërsëdrejti e merrni dhe ju përgjigjjen. Ne kemi insistuar në forma të ndryshme edhe me vendim të kryetarit që i ka nxjerr për realizimin e këtyre pagesave dhe me emaila që ju

kam shënuar Ministrisë së Financave që thotë që ekziston rregullorja në fuqi dhe përveq komiteteve obligative nuk lejohen pagesa tjera. Tani kemi telashe dhe me KKSBB-në që nuk lejojnë ta paguajmë. Nëse dëshironi të bindeni dhe vetë mundemi të shkojmë në Ministri të Financave.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Alban!

Alban Kastrati (anëtar nga PDK): Drejtor, a është lëshuar ndonjë udhëzim administrativ apo është bërë ndonjë ndryshim i Rregullores dhe nëse është lëshuar një udhëzim administrativ tregona në cilën datë, në cilin vit ka hyrë në fuqi.

Blerim Thaçi Drejtor për Buxhet dhe Financa: Është rregullorja, pas hyrjes në fuqi të ligjit të pagave, dmth menjëherë me listë të pagave.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj (anëtar nga PDK): Drejtor, pasi po thua që nuk kam të drejtë, a ka pasur të drejtë të paguhet komisioni i statuti i komunës sepse pagesat për atë komision janë ekzekutuar. A kemi një shkelje të asaj rregullore?

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Drejtor!

Blerim Thaçi Drejtor për Buxhet dhe Financa: Disa komisione brenda një institucioni, organizatat buxhetore që janë jashtë kompetencave të zyrtarëve lejohen të paguhen nga kategoria e pagave.

Nebih Bibaj (anëtar nga PDK): Komisioni që i kanë zgjedhur 22 bashkësi lokale a është jashtë punës që e bëjnë.

Blerim Thaçi Drejtor për Buxhet dhe Financa: Ata thonë që është punë e kuvendit. Unë jam munduar në të gjitha format, i'a kam shpjeguar janë vendimet e Kuvendit, janë regjistratat, janë raportet mirëpo nuk kanë lejuar.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Agnesa!

Agnesa Kastrati(anëtare nga VV): Ajo çka vërehet është ndryshimi i qëndrimit të vetë ekzekutivit në raport me këtë qështje, për shkak se në këtë kuvend ne kemi pasur zotim nga ekzekutivi që këto pagesa do të kryhen dhe arsyeja që nuk janë bërë deri tani është mungesa e financave. Ky kuvend kur ka votuar rialokim të shumave buxhetore ne kemi votuar dhe kemi ndarë buxhet për pagesa të këtyre komisioneve. Tani nuk po thuhet që nuk ka financa, por tani po na thuhet që është e jashtëligjshme. Në anën tjetër ajo që duhet me sjellë në vëmendje është që në këtë kuvend nga anëtarë të ndryshëm qoftë mazhurancë apo opozitë janë ngritë, që në një komision ka pasur anëtarë që janë paguar dhe disa të tjerë që nuk janë paguar.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Është një situat konfuze sa herë që e kemi diskutuar këtë qështje. Me qenë një komision për ndryshim in e Statutit që ka të bëjë brenda këti objekti dhe me kanë detyrë jashtë kompetencave ose detyrë tjetër shtesë për anëtarin e kuvendit dhe me dalë nëpër fshatra me i zgjedhë këshillat lokal, mos me qenë detyrë shtesë këtë nuk po e kuptoj. Është mirë nëse Ministria ka dhënë një aso vendimi që ai komision ka bërë detyrë shtesë dhe ky komision nuk ka qenë shtesë është mirë që atë email me sjellë tek ne që ta shikojmë. Kur ka qenë komisioni për zgjedhjen e bashkësive lokale, nuk ka qenë në fuqi ajo rregullore. Ajo është vonuar qëllimshëm dhe ka ardhur në këso lloj shtate. Alternativa jonë e fundit është gjykata.

Kryesusi i kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Së pari për me i dhënë peshën e duhur konsideroj më tepër peshon ajo se sa zbatohen vendimet e kuvendit, si organi më i lartë i një organizate buxhetore se sa pagesat kundrejtë humbjeve që i kanë bërë anëtarët e kuvendit, kjo është shumë e rëndësishme sepse ne kryejm punë dhe pa pagesë. Nuk është qeshtja vetëm te pagesa miërpo është qështja tek pesha e vendimeve të kuvendit.

Kërkoj nga ekzekutivi dhe nga ju si kryesues me i'a dërgu një shkresë drejtorit të thesarit Nystret Koca dhe me kërkuar pse i keni thënë komunës të Malishevës këto janë të jashtëligjshme dhe me vërtetu pse janë te jashtëligjshme. Gjithçka që është e drejtë dhe na takon duhet me pas.

Javën e kaluar është publikuar thirrja për subvencionimin për izolim termik të shtëpive dhe çka ka ndodhur në këtë thirrje është skandali më i madh, për veç atyre politikave të jashtme që i kanë bërë. Kam komunikuar me dhjetra auditor dhe çka thojnë auditorët, ka 1-2 muaj ne i kemi plotësuar të gjitha raportet dhe në momentin që është shpall thirrja kanë qen vetëm 3-ditë, raportet kanë qenë të gatshme dhe vetëm i kanë futur në sistem. Kjo është një qështje e ndjeshme sepse ju ka mohuar njerëzve të cilët kanë pasur nevojë për izolimin e shtëpive të tyre. Ndoshta ka ndodhur për shkak që është publikuar data e zgjedhjeve dhe i kanë përgaditur gjërat. Për mua dhe për shumicën e njerëzve kjo ka qenë një skenar i përgaditur.

Kryesusi i Kuvendit Argjend Thaçi: Në pajtim me të gjithë shefat e grupeve parlamentare u pajtuam që në këtë seancë do ti trajtojmë vetëm kërkesat financiare dhe të tjerat të shtyhen në një seancë tjetër për shkak të situatës të krijuar. Urdhëro, Halil!

Halil Morina(anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Ne morëm vesh mos me u trajtuar raportet, ndërsa pikat që janë kërkesa nga qytetarët me i trajtuar.

Kryesusi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Arlind!

Arlind Morina(anëtar nga LDK): Kryesus, nëse është kërkesë e qytetarve është mirë të trajtohet.

Kryesusi i Kuvendit Argjend Thaçi: Kush është për që pika parë, pika dytë, pika e tretë, të largohet nga rendi ditës?

Me vota unanime të 23-antarë tri pikat e para largohen nga rendi ditës dhe shtyhen në një mbledhje tjetër

Kush është për miratimin e rendit të ditës?

Me vota unanime 23-antarve aprovohet rendi i ditës

Unë propozoj që ti ndajmë nga 1500E për secilën kërkesë.

Kush është për miratimin e kërkesës nr.01/161 datë:28.03.2024, ti ndahet shuma 1500E?

Me vota unanime të 23 anëtarëve miratohet kjo kërkesë.

Kush është për miratimin e kërkesës nr.02/204 datë:17.05.2024, që ti ndahen në shumë prej 1500E?

Me vota unanime të 23 anëtarëve, kësaj kërkesë i ndahen 1500E.

Kush është për miratimin e kërkesës nr.02/358 datë:20.08.2024, ti ndahen 1500E?

Me vota unanime të 23 anëtarëve, kësaj kërkesë i ndahen 1500E.

Kush është për miratimin e kërkesës nr.02/353 datë:09.08.2024, ti ndahet shuma prej 1500E për trajtim shëndetësor?

Me vota unanime të 23 anëtarëve, kësaj kërkesë ti ndahen 1500E.

Kalojmë në pikën e fundit shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.08/363 datë: 22.08.2024. Është kërkesë për këmbimin e pronës private me pronë publike brenda të njëjtës zonë kadastrale konform dispozitave ligjore në fuqi të Republikës së Kosovës. Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj (anëtar nga PDK): Pikat për shëndetësi janë të arsyeshme me i kaluar mirëpo tek pikat e pronave prezent duhet të jetë drejtori i gjeodozisë dhe kadastër me dhënë arsyen pse po këmbëhet kjo pronë. Janë disa gjëra që duhet të pasur kujdes.

Kryesusi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro Halil!

Halil Morina(anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Nëse e shohim këtë kërkesë që është bërë, i kemi të dhënat dhe arsyeshmërinë pse po bëhet ky këmbim. Flitet për një pronë në GOLESH dhe hapësira që ka mu këmbyer është 30m dhe qëllimi është drejtimi. Interesi është i dy anshëm i Komunës edhe i qytetarëve.

Kryesusi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Agnesa!

Agnesa Katrati (anëtare VV): Në emër të grupit të Lëvizjes Vetëvendosje, në kërkesë është paraqitur arsyeshmëria edhe është e vërtet që kërkesa është e kompletuar por është aspekti individual i personit që e ka parashtruar kërkesën prandaj do të duhet që të jetë edhe drejtori prezent këtu që të na informoj interesin që e ka komuna sepse ne në kërkesë po e shohim vetëm interesin e një individi.

Kryesusi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Tek dokumentet e gjeodezisë dhe plani i kadastrës po shihet që këtu është kërkuar që në rrugë kryesore me ja dhënë shtetit dhe me e marr një pjesë mbrapa.

Kryesusi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Hamit!

Hamit Lima(anëtar nga LDK): Tek prona e kemi ngritur si shqetësim për këto këmbime dhe devijime, dhe drejtori duhet të na jep një sqarim a është interesi i Komunës. Unë kërkoj që kjo të shtyhet për një mbledhje tjetër prezent të jetë dhe drejtori dhe të na sqaroj rreth kësaj qështje.

Kryesusi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Arlind!

Arlind Morina (anëtar nga LDK): Mendoj që debati u shtjerr. Aty ka të bëjë me një pjesë ku Komuna në këtë rast përfiton sepse i zgjerohet rruga. Është mirë që ne të marrim vendim, e dërgojmë në Ministri dhe ajo na kthen përgjigjen pozitiv apo negativ.

Kryesusi i Kuvendit Argjend Thaçi: Duhet të marrim dy vendime së pari shpallje në zonë me interes të përgjithshëm publik dhe pastaj këmbimi i pronës. Njësia kadastrale P723 1004- 7-01004-22 në vendin e quajtur Golesh në sipërfaqe të përgjithshme prej 450m zona kadastrale në Malishevë dhe pjesës së njësies kadastrale nr.1/1 P72310047-01004-21 në vendin e quajtur Golesh në sipërfaqe prej 450m, ndërsa të dyja zonat kapin sipërfaqe prej 900m zona kadastrale në Malishevë. Qëllimi i kërkesës është parashtruar për këmbim në pjesën e njësies kadastrale nr.P72310047-01004992 në vendin e quajtur Golesh në sipërfaqe të përgjithshme prej 14584m në pronësi të Komunës së Malishevës. Në bazë të matjes gjeodezike konstatohet se është e nevojshme të këmbehet prona publike në sipërfaqe prej 33m. Kush është që kjo pronë të shpallet zonë me interes të përgjithshëm publik?

Për:11

Kundër:1

Abstenim :11

Me 11 vota për, një kundër dhe 11 abstenime, kjo pikë kalon.

Kush është për këmbimin e kësaj prone sipas kërkesës së parashtruar?

Për: 11

Kundër:1

Abstenim:11

Me 11 vota për, 1 kundër dhe 11 abstenime, miratohet kjo pikë.

Tek pika të ndryshme a e dëshironi fjalën. Këtë mbledhje e shpalli të mbyllur. Ju falënderoj për pjesëmarrje!

Përfundoi në ora:12:20.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina



Kryesuesi i Kuvendit

Argjend Thaçi



